

## STATUTI I GJYKATES NDERKOMBETARE TE DREJTESISE

Neni 1

GJYKATA NDERKOMBETARE E DREJTESISE qe themelohet nga Karta e Kombeve te Bashkuara si organi gjyqesor kryesor i Organizates do te formohet dhe do te funksionoje simbas dispozitave te ketij Statuti.

### KAPITULLI I ORGANIZIMI I GJYKATES

Neni 2

Gjykata eshte nje trup gjyqtareash indipendente, te zgjedhur, pa mare parasysh shtetesine e tyre, midis personave qe gezojne konsideraten morale me te larte dhe qe kane konditat e duhura per te ushtruar ne vendet e tyre respektive, funksionet gjyqesore me te larta, ose qe jane juriskonsule me kompetence te njojur ne fushen e se drejtis nderkombetare.

Neni 3

1) Gjykata perbehet nga pesembedhjete antare, nder te cilet nuk mund te kete me shume se nje shtetas nga i njejt shtet.

2) Ne lidhje me kete pike ay qe mund te kete me shume se nje shtetesi, do te konsiderohet se eshte shtetas i atij shteti ku ushtron zakonisht te drejtat e tij civile dhe politike.

Neni 4

1) Antaret e Gjykates zgjidhen nga Asambleja e Pergjitheshme dhe nga Keshilli i Sigurimit mbi nje liste personash te paraqitur nga grupet kombetare te Gjykates se Perhereshme t'Arbitrazhit, simbas dispozitave qe vijojne.

2) Persa i perket Antareve te Kombeve te Bashkuara qe nuk jane te perfaqsuar ne Gjykaten e Perhereshme t'Arbitrazhit, kandidatet e tyre do te paraqiten nga grupe kombetare, te caktuara per kete qellim nga qeverite e tyre, ne po ato kondita qe zbatohen per antaret e Gjykates se Perhereshme t'Arbitrazhit, ne baze te nenit 44 te Konventes se Hages te vitit 1907 mbi regullimin paqesor te konflikteve nderkombetare.

3) Ne mungese te nje mareveshjeje te vecante, Asambleja e Pergjitheshme do te rregulloje, mbi rekomandimin e Keshillit te Sigurimit konditat ne te cilat mund te mare pjese ne zgjedjen e antareve te Gjykates nje shtet i cili, me gjithse eshte pale ne kete statut, nuk eshte Antar i Kombeve te Bashkuara.

Neni 5

1) Tre muaj te pakten para dates se zgjedhjeve, Sekretari i Pergjitheshem i Kombeve te Bashkuara i fton me shkres Antaret e Gjykates se Perhereshme t'Arbitrazhit qe u perkasin shteteve pale ne kete Statut si dhe Antaret e grupeve kombetare te caktuara simbas paragrafit 2 te nenit 4, qe te paraqesin brenda nje afati te caktuar, simbas grupeve kombetare, personat qe jane ne gjendje te perm bushin funksionet e Antarit te Gjykates.

2) Cdo grup nuk mund, ne asnje rast, te paraqese me shume se kater persona nga te cilet te shumten dy, mund te jene me shtetesi te tij. Neasnje rast, nuk mund te paraqite nje numur kandidatesh me i larte se dyfishi i vendeve per t'u plotesuar.

Neni 6

Para se te caktohen keta persona, i rekomandohet qdo grapi kombetar qe te konsultohet me gjykatene te larte te drejtisese, fakultetet e shkollat e drejtisese, akademite kombetare dhe sektionet kombetare te akademive nderkombetare, qe meren me studimin e drejtisese.

Neni 7

1) Sekretari i Pergjitheshem preqatit, simbas rendit alfabetik, nje liste te gjithe personave te caktuar; zgjedha behet vetem per keta persona por ka edhe raste perjashtimi qe parashkohen ne nenin 12, paragrafi 2.

2) Sekretari i Pergjitheshem i a njofton kete liste Asamblese se Pergjitheshme dhe Keshillit te Sigurimit.

Neni 8

Asambleja e Pergjitheshme dhe Keshilli i Sigurimit bejne, pavaresisht njeri nga tjetri, zgjedhjen e antareve te Gjykates.

Neni 9

Ne qdo zgjedhje, zgjedhesit duhet te kene parasysh qe personat qe do te zgjidhen antare te Gjykates duhet jo vetem te zoterojne individualist konditat e duhura, por edhe te sigurojne ne per gjithesi perfaqesimin e formave te medha te qyteterimit dhe te sistemeve juridike kryesore ne bote.

Neni 10

1) Konsiderohen te zgjedhur ata qe kane fituar shumicen absolute te votave ne Asamblene e Pergjitheshme dhe ne Keshillin e Sigurimit.

2) Votimi ne Keshillin e Sigurimit, qofte per zgjedhjen e gjyqtareve qofte per emerimin e antareve te Komisionit te permendor ne nenin 12 ketu poshte,

do te kryhet pa u bere asnjë dallim midis antareve te perhershëm dhe antareve jo te perhershëm te Keshillit te Sigurimit.

3) Ne rast se votimi i dyfishte ne Asamblene e Pergjitheshme dhe ne Keshillin e Sigurimit do te kishte si perfundim zgjedhjen e me shume se nje shteti te po nje shteti, konsiderohet si i zgjedhur ay qe eshte me i math nga mosha.

#### Neni 11

Ne qofte se, pas seances se pare te zgjedhjes, do te kene mbetur ende vende per tu plotesuar, do te mbahet ne te njejtën menyre, nje seance e dyte dhe, ne rast nevoje, nje e trete.

#### Neni 12

1) Ne qofte se, pas seances se trete te zgjedhjeve, do te mbeten ende vende per tu plotesuar, mund te formohet ne çdo moment mbi kerkesen e Asamblese se Pergjitheshme ose te Keshillit te Sigurimit, nje komision ndermjetesonjes me gjashte antare te emeruar tre prej Asamblese se Pergjitheshme, tre prej Keshillit te Sigurimit, me qellim qe te zgjedhe me nje votim me shumice absolute, per çdo vend te pa plotesuar, nje emer per tia paraqitur Asamblese se Pergjitheshme dhe Keshillit te Sigurimit qe t'a pranojne veç e veç.

2) Komisioni ndermjetesonjes mund te vere ne listen e tij emerin e çdo personi qe permblush konditat e duhura dhe qe permblehdh unanimitetin e votave te tij, edhe sikur ay te mos kete qene shenuar ne listen e emerave per te cilen behet fjale ne nenin 7.

3) Ne qofte se Komisioni ndermjetesonjes nuk arin te siguroje zgjedhjen, ahore antaret e Gjykates t'emeruar me pare do te plotesojne vendet vakante, brenda nje afati qe do te caktohet nga Keshilli i Sigurimit, duke zgjedhur midis personave qe kane fituar vota ose ne Asamblene e Pergjitheshme ose ne Keshillin e Sigurimit.

4) Ne qofte se votat e gjyqtareve udahen ne dy grupe te barabarta, atehere do te konsiderohet e vlefshme vota e gjyqtarit me te math nga mosha.

#### Neni 13

1) Antaret e Gjykates zgjidhen per nende vjet dhe mund te rizgjidhen, me gjithe kete, persa i perket gjyqtareve t'emeruar ne zgjedhjet e para te Gjykates, funksionet e pese gjyqtareve do te marin fund ne mbarim te tre vjeteve, dhe ato te pese gjyqtareve te tjere ne mbarim te gjashte vjeteve.

2) Gjyqtaret, funksionet e te cileve do te marrin fund ne mbarim te perudhave fillestare prej tre dhe gjashte vjetesh te permendura me siper, do te caktohen duke u hedhur ne short prej Sekretarit te Pergjitheshem me nje here pasi te jene bere zgjedhjet e para.

3) Antaret e Gjykates qendrojne ne detyra gjersa te zevendesohen. Pas zevendesimit te tyre ata do te vazhdojne te meren me çeshtjet qe i kane filluar me pare.

4) Ne rast doreheqje te nje antari te Gjykates, doreheqja duhet t'i drejtohet Kryetarit te Gjykates per t'u transmetuar Sekretarit te Pergjitheshem. Me kryerjen e ketij njoftimi te fundit vendi i gjyqtarit doreheqes konsiderohet vakant.

#### Neni 14

Vendet e mbetura vakant plotesohen simbas metodes se ndjekur ne zgjedhjet e para, nen rezerven e dispozites qe vijon: brenda nje muaji pasi mbetet vendi vakant, Sekretari i Pergjitheshem do te dergoje ftesen e permendor ne nenin 5 dhe data e zgjedhjes do te caktohet nga Keshilli i Sigurimit.

#### Neni 15

Antari i Gjykates qe zgjidhet per te zevendesuar nje antar mandati i te cilin nuk ka mbaruar, do te qendroje ne detyre deri ne mbarimin e mandatit te paraardhesit te tij.

#### Neni 16

1) Antaret e Gjykates nuk mund te ushtrojne asnjë funksion politik ose administrativ dhe nuk mund te meren me asnjë pune tjeter me karakter profesional.

2) Kur ka dyshim mbi kete pike, vendos Gjykata.

#### Neni 17

1) Antaret e Gjykates nuk mund te ushtrojne funksionet e agjentit, te keshilltarit ligjor ose te avokatit ne asnjë çeshtje.

2) Ata nuk mund te marin pjese ne rregullimin e asnjë çeshtjeje per te cilin ata kane vepruar me pare si agjente, keshilltar ligjore ose avokate te ndonjeres nga palet, si anetare te ndonje gjykate kombetare ose ndrekombetare, te ndonje komisioni hetimor ose me çdo cilesi tjeter.

3) Kur ka dyshim, vendos Gjykata.

#### Neni 18

1) Antaret e Gjykates nuk mund te pushohen veçse ne rast kur simbas mendimit unanim te Antareve te tjere, ata nuk i permblushin me konditat e duhura.

2) Per kete gje, Kryesekretari i Gjykates i jep njoftim zyrtarisht Sekretarit te Pergjitheshem.

3) Ky njoftim e ben vendin vakant.

#### Neni 19

Antaret e Gjykates gezojne, ne ushtrimin e funksioneve te tyre, privilegjet dhe imunitetet diplomatike.

#### Neni 20

Para se te filloje nga detyra çdo antar i Gjykates duhet qe ne seance publike, te mare detyrimin solemn, t'ushtroje fuqite e tij, me paanesi dhe ndergjegje te plote.

#### Neni 21

1) Gjykata emeron, per tre vjet, Kryetarin dhe nen-Kryetarin e saj; keta mund te rizgjidhen.

2) Ajo emeron Kryesekretarin e saj dhe mund te beje emerimet e atyre në punesve qe do te shihen te nevojeshem.

Neni 22

1) Selia e Gjykates vendoset ne Hage. Me gjithe kete Gjykata mund te mbaje seanca dhe mund te ushtroje funksionet e saj gjetiu ne se e gjykon te desherueshme.

2) Kryetari dhe Kryesekretari e kane qendren e tyre ne Salline e Gjykates.

Neni 23

1) Gjykata qendron gjithnjne ne funksionim, perveç ne pushimet gjyqesore, koha dhe zgjatja e te cilave caktohen nga Gjykata.

2) Antaret e Gjykates kane te drejte te marin leje periodike data dhe zgjatja e te cilve do te caktohen nga Gjykata duke mare parasysh distancen qe ndan Hagen nga vend-banimi i tyre.

3) Antaret e Gjykates jane te detyruar te qendrojne ne çdo kohe ne dispozicion te Gjykates, perveç kur jane me leje, dhe kur jane te penguar per shkak semundjeje ose per çdo shkak tjeter te rende te justifikuar prane Kryetarit.

Neni 24

1) Ne qofte se, per ndonje arsyte te posaçme, nje nga antaret e Gjykates mendon se duhet te mos mare pjese ne gjykimin e nje çeshtje te caktuar, ay i a ben te ditur kete Kryetarit.

2) Ne qofte se Kryetari mendon se nje nga antaret e Gjykates nuk duhet, per nje arsyte te posaçme, te mare pjese ne gjykimin e nje çeshtjeje te caktuar, ay e lajmeron ate per kete gje.

3) Kur, ne raste te ketilla, antari i Gjykates dhe Kryetari jane me mendime te kunderta, ahene vendos Gjykata.

Neni 25

1) Gjykata vepron ne seanca plenare vec kur ka perjashtim te parashekuar shprehimisht nga ky Statut.

2) Me kondite qe numuri i gjyqtareve disponibel, per perberjen e Gjykates te mos zbere nen njemedhjete, Rregullorja e Gjykates mund te parashekoje qe simbas rr Ethanave dhe me radhe, nje ose me shume gjyqtare mund te mos marin pjese ne mbledhjen e trupit gjyques.

3) Numuri i nevojshem i Gjykates per te mare vendime duhet te jete prej nende gjyqtare.

Neni 26

1) Gjykata mund te formoje, ne çdo kohe, nje ose me shume dhoma te perbera nga te pakten tre gjyqtare, si te vendose ajo vete, me qellim qe te meren me kategori te caktuara çeshtjesh, per shembell me çeshtje te punes dhe me çeshtje qe kane te bejne me transitin dhe komunikacionet.

2) Gjykata mund te formoje, ne çdo kohe, nje dhoma qe te meret me nje çeshtje te caktuar. Numuri i gjyqtareve te kesaj dhoma do te caktohet prej Gjykates me pelqimin e paleve.

3) Dhomat e parashekuara nga ky nen do te gjykojne dhe do te jatin vendim mbi çeshtjen ne se e kerkojne palet.

Neni 27

Cdo vendim qe jepet nga nje prej dhomat te parashekuara nga nenet 26 dhe 29 do te konsiderohet se eshte dhene nga Gjykata.

Neni 28

Dhomat e parashekuara nga nenet 26 dhe 29, me pelqimin e paleve mund te mblidhen dhe te ushtrojne funksionet e tyre ne vende te tjera perveç Hages.

Neni 29

Me qellim qe te kryeje punet sa me shpejt. Gjykata formon çdo vit nje dhoma prej pese gjyqtarosh, te cilet do te kene per detyre te gjykojne dhe te jatin vendim me procedure te shpejte kur palet e kerkojne. Dy gjyqtare do te emerohen gjithashtu per te zevendesuar ndonje nga gjyqtaret qe do te ishte ne pa mundesi te merte pjese ne seancat.

Neni 30

1) Gjykata cakton me anen e nje rregulloreje menyrene se si do t'i ushtroje funksionet e saj. Ajo cakton sidomos proceduren e saj.

2) Rregullorja e Gjykates mund te parashekoje pjsemaren, pa te drejte vote, te ndihmes-gjyqtareve ne Gjykate ose ne dhomat e saj.

Neni 31

1) Gjyqtaret qe kane shtetesine e çdo pale e ruajne te drejten qe te marin pjese ne gjykimin e çeshtjes qe i eshte parashekuar Gjykates.

2) Ne qofte se Gjykata permbar nje gjyqtar me shtetesi te njerës nga palet, çdo pale tjeter mund te zgjedhe nje person qe te mare pjese ne gjyq si gjyqtar. Ne zgjedhjen e ketij, duhet te preferohet nje nga personat e caktuar simbas neneve 4 dhe 5.

3) Ne qofte se Gjykata nuk permbar asnjë gjyqtar me shtetesi te paleve, çdo pale mund te caktoje nje gjyqtar ne menyren e treguar ne paragafin e meparshem.

4) Ky nen zbatohet ne rastin e neneve 26 dhe 29. Ne te tilla raste, Kryetari i lutet njerit, ose kur e lyp puna, dy antareve te Gjykates qe perberjne dhomen, qe tua lene vendet e tyre antareve te Gjykates qe kane shtetesine e paleve te interesuara, dhe ne rast mungese ose ne rast pengese, gjyqtareve posaçerisht te caktuar nga palet.

5) Kur shume pale kane ne nje gjyq interes te perbashket, ato llogariten, per zbatimin e dispozitave te mepareshme, si nje pale e vetme. Kur ka dyshim, vendos Gjykata.

6) Gjyqtaret e caktuar simbas paragrafeve 2, 3 dhe 4 te ketij nen, duhet te permbojhin konditat e neneve 2, 17 paragrafi 2, 20 dhe 24 te ketij Statuti. Ata marin pjese ne vendimin ne kondita barazije te plotë me koleget e tyre.

### Neni 32

- 1) Antaret e Gjykates marin nje rroge vjetore.
- 2) Kryetari mer nje alokacion vjetor te posaçem.
- 3) Nen-Kryetari mer nje alokacion te posaçem per çdo dite qe perm bush funksionet e Kryetarit.
- 4) Gjyqtaret e caktuar ne zbatim te nenit 31 dhe qe nuk jane antare te Gjykates, marin nje shperblim per çdo dite qe ushtrojne funksionet e tyre.
- 5) Keto rroga, alokacione dhe shperblime caktohen prej Asamblese se Pergjitheshme. Ato nuk mund te pakesohen deri sa vazhdojne funksionet.
- 6) Rroga e Kryesekretarit te Gjykates caktohet prej Asamblese se Pergjitheshme mbi propozimin e Gjykates.
- 7) Nje rregullore e pranuar nga Asambleja e Pergjitheshme cakton kushtet nen te cilat do t'u jepen pensione Antareve te Gjykates dhe Kryesekretarit, si dhe kushtet nen te cilat do te paguhën shpenzimet e udhetimit te bera nga Antare te Gjykates dhe Kryesekretarit te saj.
- 8) Rrogat, alokacionet dhe shperblimet perjashtohen nga çdo tatim.

### Neni 33

Shpenzimet e Gjykates i ngarkohen Kombeve te Bashkuara sipas menyrës që vendos Asambleja e Pergjitheshme.

## KAPITULLI II.

### KOMPETENCA E GJYKATES

#### Neni 34

- 1) Te drejtën per t'u paraqitur perpara Gjykates e kane vetem shtetet.
- 2) Gjykata, nen kushtet e caktuara nga Rregullorja e saj, mund t'u kërkoje organizatave nderkombetare publike informata ne lidhje me çeshtjet qe i Jane parashtruar, dhe do te pranoje gjithash tu informata ne fjale kur keto do t'i paraqiteshin nga keto organizata me inisiativen e tyre.
- 3) Kur interpretimi i aktit kushtetonjes te nje organizate nderkombetare publike ose ay i nje konvente nderkombetare te adoptuar ne baze te ketij akti vihet ne bisedim ne nje çeshtje qe i eshte parashtruar Gjykates, Kryesekretari i kesaj e lajmeron per kete gje ate organizate dhe i njofton te gjithe proceduren e shkruar.

#### Neni 35

- 1) Gjykata qendron e hapet per shtetet pale ne kete Statut.
- 2) Kushtet nen te cilat to te jete e hapet per shtetet e tjere rregullohen, nen rezerven e dispozitave te veçanta te traktateve ne fuqi nga Keshilli i Siguimit, dhe, ne te gjitha rastet, rregullohen ne menyre qe te mos rezultoje per palet asnjë pabarazi perpara Gjykates.
- 3) Kur nje shtet, qe nuk eshte Antar i Kombeve te Bashkuara eshte pale ndergjyqese, Gjykata do te caktoje kontributin qe duhet t'i ngarkohet kesaj pale ne shpenzimet e Gjykates. Kjo dispozita nuk do te zbatohet ne qofte se ky shtet mer pjesë ne shpenzimet e Gjykates.

#### Neni 36

- 1) Kompetenca e Gjykates shtrihet ne te gjitha çeshtjet qe do t'i parashtrohen nga palet, si dhe ne te gjitha rastet posaçerisht te parashekuara nga Karta e Kombeve te Bashkuara ose nga traktatet die konventat ne fuqi.
- 2) Shtetet qe Jane pale ne kete statut mund te deklarojne, ne çdo kohe, se e njohin si te detyrueshme, me të drejtë te plete dhe pa konventa te posaçme, perkundrejt çdo shteti tjeter qe pranon te njejtin detyrim, juridikjonin e Gjykates mbi te gjitha grindjet me karakter juridik qe kane per objekt:
  - a) interpretimin e nje traktati;
  - b) çdo pike te se drejtës nderkombetare;
  - c) realitetin e çdo fakti i cili, po te provojë do te perbente shkeljen e nje detyrimi nderkombetar;
  - c) natyren ose sasine e reparacionit qe duhet dhene kur prishet nje angazhim nderkombetar;
- 3) Deklaratat e naltpermendura mund te behen pa ndonje kondite ose nen konditen e reciprocitetit nga ana e shume ose disa shteteve, ose per nje afat te caktuar.
- 4) Keto deklaratat do t'i dorezohen Sekretarit te Pergjitheshem te Kombeve te Bashkuara i cili do t'u dergoje kopjen paleve te ketij Statuti si dhe Kryesekretarit te Gjykates.
- 5) Deklaratat e bera ne zbatim te nenit 36 te Statutit te Gjykates se Perhereshme te Drejtësise nderkombetare per nje kohe qe nuk ka skaduar akoma do te konsiderohen, ne maredheniet midis paleve te ketij Statuti, se vlefje si pranim i juridiksonit te detyruarshem te Gjykates nderkombetare te Drejtësise per kohen qe nuk ka kaluar akoma ne baze te ketyre deklaratave, dhe simbas dispozitave te ketyre.
- 6) Ne rast se ka kundershtim per te ditur ne se Gjykata eshte kompetente, vendos Gjykata.

#### Neni 37

Kur nje traktat ose nje konvente ne fuqi parashekon qe nje çeshtje t'i referohet nje juridiksoni qe do te themelojë nga Lidhja e Kombeve ose Gjykates se Perhereshme te Drejtësise nderkombetare, çeshtja do t'i parashtrohet Gjykates nderkombetare te Drejtësise si juridikson midis paleve ne kete Statut.

#### Neni 38

- 1) Gjykata, misioni i se ciles eshte qe te rregulloje simbas se drejtës nderkombetare grindjet qe i parashtron, zbaton:
  - a) konvantat nderkombetare, qofshin te pergjitheshme ose te posaçme qe permbyaje rregulla shprehimisht te njohura nga Shtetet ne grindje;
  - b) zakonet nderkombetare si prove te nje praktike te pergjitheshme te pranuar si ligj;
  - c) parimet e pergjitheshme te se drejtës te njohura prej vendeve te qytetëruara;
- ç) nen rezerven e dispozites se nenit 59, vendimet gjyqesore dhe doktrinen e publikisteve me te cilesuar te vendeve te ndryshme si mjet ndihmes per te caktuar rregullat e se drejtës.

2) Kjo dispozite nuk cenon te drejten qe ka Gjykata, ne qofte se palet e pranojne, qe te vendoset: ex aequo et bono.

### KAPITULLI III.

#### PROCEDURA

##### Neni 39

1) Gjuhet zyrtare te Gjykates jane frengjishtja dhe inglishtja. Ne qofte se palet pranojne qe gjithe procedura te behet ne frengjisht, gjykimi do te jepet ne kete gjuhe. Ne qofte se palet pranojne qe gjithe procedura te behet ne inglisht, gjykimi do te jepet ne kete gjuhe.

2) Ne mungesen e nje mareveshjeje qe do te caktoje gjuhen qe do te perdoret, palet mund te perdonin ne mbrojtjet e tyre ate nga te dy gjuhet qe do te preferojne dhe vendimi i gjyqit do te jepet ne frengjisht dhe ne inglisht. Ne kete rast, Gjykata do te tregoste njekohesisht nga te dy tekstet ate qe do te konsiderohet i vlefshem.

3) Gjykata do te autorizeje, mbi kerkesen e cdo pale, perdonimin nga ana e kesaj te nje gjuhe tjeter veç frengjishtes dhe inglishtes.

##### Neni 40

1) Çeshtjet paraqiten para Gjykates, simbas rastit, ose me njoftimin e kompromisit, ose me anen e nje kerkesa drejtuar Kryesekretarit te Gjykates; ne te dy rastet, duhet te tregohen objekti i grindjes dhe palet.

2) Kryesekretari ua njofton me nje here kerkesen te gjithe te interesuarve.

3) Ay informon gjithashtu Antaret e Kombeve te Bashkuara me ndermjetesine e Sekretarit te Pergjitheshem si dhe shtetet e tjere qe kane te drejte te ngrehin padije perpara Gjykates.

##### Neni 41

1) Gjykata ka fuqi per te treguar, ne se e gjykon te nevojeshme per shkak te rethanave, se ç'fare masa konservative provizore duhet te meren per te ruajtur te drejtat e seicilit.

2) Duke pritur vendimin definitiv, keto masa u njoftohen me nje here paleve dhe Keshillit te Sigurimit.

##### Neni 42

1) Palet perfqaqsohen me ane agjentesh.

2) Ato mund te ndihmohen perpara Gjykates me ane keshilltaresh ligjore ose avokatesh.

3) Agjentet, keshilltaret ligjore dhe avokatet e paleve perpara Gjykates do te gezojne privilegjet dhe imunititetet e nevojeshme per ushtrimin e pavarrut te funksioneve te tyre.

##### Neni 43

1) Procedura ka dy faza: njera e shkruar, tjetra verbale.

2) Procedura e shkruar permblehdh komunikimin Gjykates dhe paleve te

promemorieve, kunder-promemorieve dhe eventualisht te pergjigjeve, si dhe te gjithe akteve e dokumentave qe i mbeshtetin.

3) Komunikimi behet me ndermjetesine e Kryesekretarit te Gjykates simbas radhes dhe afateve te caktuara nga Gjykata.

4) Cdo akt i paraqitur prej njeres nga palet duhet t'i komunikohet tjetres me anen e nje kopjeje te vertetuar.

5) Procedura me goje konsiston ne degjin e deshmitareve, eksperteve, agjenteve, keshilltareve ligjore dhe avokateve nga ana e Gjykates.

##### Neni 44

1) Per cdo notifikim qe duhet t'u behet personave te tjere, veç agjenteve, keshilltareve dhe avokateve, Gjykata i drejtohet direkt qeverise se shtetit ne token e te cilil duhet te kete efekt notifikimi.

2) Veprohet ne te njejten menyre kur duhet proceduar ne vend, per te gjetur gjithe mjetet provuese.

##### Neni 45

Gjyqi zhvillohet nen drejtimin e Kryetarit dhe ne mungesen e ketij, te zev. kryetarit, ne rast se ky eshte i penguar drejtohet nga me i vjetri i gjyqtareve te pranishem.

##### Neni 46

Seanca e gjyqit eshte publike, veç kur vendoset ndryshe nga Gjykata ose kur te dy palet kerkojne qe te mos pranohet publiku.

##### Neni 47

1) Per cdo seance mbahet nje proces-verbal i neneshkuar prej Kryesekretarit te Gjykates dhe Kryetarit.

2) Vetem ky proces-verbal ka karakter autentik.

##### Neni 48

Gjykata nxjer urdheresa per drejtimin e gjyqit, per caktimin e formave dhe te afateve nen te cilat duhet cdo pale te mbroje perfundimisht te drejtat e saj, ajo mer te gjitha masat e nevojeshme per perdonimin e provave.

##### Neni 49

Gjykata edhe para se te filloje cdo debat mund t'u kerkoje agjenteve qe te paraqesin cdo dokument dhe te japin te gjitha shpjegimet. Ne rast refuzimi, ajo mban shenim per kete gje.

##### Neni 50

Ne cdo moment, Gjykata mund t'i besoje hetime ose ekspertime cdo personi, trupi, zyre, komisioni ose organi qe e zgjeth ajo vete.

##### Neni 51

Deshmitareve dhe eksperteve u behen, gjate debateve, te gjitha pyetjet e nevojeshme nen konditat e caktuara nga Gjykata ne rregulloren e permendor ne nenin 30.

### Neni 52

Pasi t'i jene parashtruar provat dhe te jene degjuar deshmitaret ne afatet e caktuara prej saj, Gjykata mund te mos i pranoje deponimet ose dokumentat e reja qe njera nga palet desheron t'i paraqese pa pelqimin e pales tjeter.

### Neni 53

- 1) Kur nje nga palet nuk paraqitet ose i shmanget perdonimit te mjetete ligjore, pala tjeter mund t'i kerkonte Gjykates qe te mare vendim ne favor te saj.
- 2) Gjykata, para se te mare nje vendim te ketille, duhet te sigurohet jo vetem qe ka kompetence simbas neneve 36 dhe 37, por qe edhe konkluzionet jane te bazuara ne fakt dhe ne te drejte.

### Neni 54

1) Kur agjentet, keshilltaret ligjore dhe avokatet kane perdonur nen kontrollin e Gjykates, te gjitha mjetet qe i gjykojne te dobishme, Kryetari deklaron se debatet kane mare fund.

- 2) Gjykata terhiqet per bisedim ne dhomen e Keshillit.
- 3) Bisidimet e Gjykates jane dhe mbeten te fshehta.

### Neni 55

1) Vendimet e Gjykates meren me shumicen e Gjyqtareve te pranishem.  
2) Ne rast se votat ndahen me dysh, vota e Kryetarit ose zevendesit te tij do te paravleje.

### Neni 56

- 1) Vendimi duhet te permbate aresyet mbi te cilat bazohet.
- 2) Ay tregon emerat e gjyqtareve qe kane mare pjese ne te.

### Neni 57

Ne qofte se vendimi nuk shpreh ne teresi ose pjeserisht mendimin unanim te gjyqtareve qdo gjyqtar ka te drejte te tregoje mendimin e tij individual.

### Neni 58

Vendimi neneskruhet prej Kryetarit dhe prej Kryesekretarit te Gjykates. Ay lexohet ne seance publike, mbasi te jene lajmeruar agjentet.

### Neni 59

Vendimi i Gjykates eshte i detyrueshem vetem per palet ne grindje dhe ne rastin per te cilin eshte mare vendimi.

### Neni 60

Vendimi eshte definitiv dhe i pa apelueshem. Ne rast kontestimi mbi kuptimin dhe efektet e vendimit, i perket Gjykates qe t'a interpretoje, mbi kerkesen e qdo pale.

### Neni 61

1) Rishikimi i vendimit mund t'i kerkohet eventualisht Gjykates vetem per shkak te zbulimit te nje fakti te nje natyre qe mund t'ushtonte nje influence vendimtare dhe qe, para se te jepej vendimi, nuk ishte ne dijenin e Gjykates dhe te pales qe kerkon rishikimin me kondite qe padija e ketij te mos jete shkaktuar nga fajti i saj.

2) Procedura e rishikimit hapet me nje vendim te Gjykates qe konstaton shprehimisht genien e faktit te ri, duke i njohur karakteret qe lejojne çeljen e rishikimit dhe duke e deklaruar per kete aresye kerkesen te pranueshme.

3) Gjykata mund te vere si kondite qe para se te çelet procedura e rishikimit te zbatohet vendimi.

4) Kerkesa per rishikim duhet te behet e shumta brenda nje afati prej gjashte muajsh pas zbulimit te faktit te ri.

5) Asnjë kerkese rishikimi nuk mund te behet pasi te kenë kaluar dhjete vjet nga data e vendimit te gjyqit.

### Neni 62

1) Kur nje shtet mendon se nje grinde prek ndonje interes juridik te tij, ay mund t'i drejtoje Gjykates nje kerkese qe te lejoje nderhyrjen e tij.

2) Gjykata mer vendim mbi kete kerkese.

### Neni 63

1) Kur behet fjale per interpretimin e nje konvente ne te cilin kane mare pjese vec paleve ne grinde edhe shtete te tjere, Kryesekretari i Gjykates i lamjeron menjehere.

2) Seicili prej tyre ka te drejte te nderhyje ne kete gjyq dhe ne qofte se e ushtron kete te drejte, interpretimi i dhene ne vendim eshte gjithashtu i detyrueshem kundrejt tij.

### Neni 64

Cdo pale ngarkohet me shpenzimet e veta te procedures, perveç kur gjykata vendos ndryshe.

## KAPITULLI IV. MENDIME KONSULTATIVE

### Neni 65

1) Gjykata mund te jape nje mendim konsultativ mbi qdo çeshtje juridike mbi kerkesen e qdo organi ose institucioni te autorizuar nga Karta e Kombeve te Bashkuara ose konform dispozitive te saj, per te kerkuar kete mendim.

2) Çeshtjet per te cilat kerkohet mendimi konsultativ i Gjykates i parashtron kesaj me nje kerkesa ku tregohet sakteisht çeshtja per te cilen kerkohet mendimi konsultativ i Gjykates. Bashkarisht paraqitet qdo dokument qe mund te sqaroje çeshtjen.

### Neni 66

1) Kryesekretari i Gjykates ua njofton menjehere kerkesen per dhenien e mendimit konsultativ gjithe Shteteve qe kane te drejte te ngrehin gjyq perpara Gjykates.

2) Perveç kesaj, Kryesekretari i Gjykates me një komunikim te posaçem e direkt drejtuar çdo shteti qe ka te drejte te ngrehe gjyq perpara Gjykates, dhe çdo organizate nderkombetare te cilet, simbas mendimit te Gjykates, ose te Kryetarit te saj kur ajo nuk eshte ne seance, Jane ne gjendje te jepin informata mbi çeshtjen, u njofton atyre se Gjykata eshte e dispozuar te pranoje parashtresa me shkrim deri ne një afat qe do te caktohet nga Kryetari, ose te degjoje parashresa gojarisht ne një seance publike te mbajtur per kete qellim.

3) Ne qofte se një nga keta shtete nuk eshte lajmeruar me komunikimin e posaçem te permendor ne paragrafin 2 te ketij nenit, mund te çfaqe deshiren qe te paraqese një parashrese me shkrim ose te degjohet. Per kete rast vendlloj Gjykata.

4) Shtetet dhe organizatat qe kane paraqitur parashresa me shkrim ose gojarisht pranohen te diskutojnë mbi parashtresat e bera nga shtete dhe organizata te tjera ne format, masat dhe afatet e caktuara, ne çdo rast te vecante prej Gjykates, ose kur kjo nuk eshte ne seance, prej Kryetarit. Per kete qellim Kryesekretari i Gjykates ua komunikon parashresat e shkruara, ne kohen e duhur, shteteve dhe organizatave qe kane paraqitur akte te tillë.

#### Neni 67

Gjykata i jep mendimet konsultative ne seance publike, mbasi te jene lajmeruar Sekretari i Pergjitheshem dhe Perfaqesonjesit e Antareve te Kombeve te Bashkuara, te shteteve te tjere dhe te organizatave nderkombetare te interesa direkt.

#### Neni 68

Ne ushtrimin e funksioneve te saj konsultative, Gjykata do te frymezohet gjithashtu nga dispozitat e ketij Statuti qe zbatohen ne çeshtjet e mbetur pezull deri ne masen qe ajo do t'i njohe te zbatueshme.

### KAPITULLI V.

#### AMENDAMENTE

#### Neni 69

Amendmentet ne kete Statut do te behen me po ate procedure qe parashhe-koitet per amendmentet ne Karten e Kombeve te Bashkuara nen rezerven e dispozitive qe, mbi rekomandimin e Keshillit te Sigurimit do te pranoheshin nga Asambleja e Pergjitheshme per te rregulluar pjesemarjen ne kete procedure, te shteteve qe nuk jane Antare te Kombeve te Bashkuara por qe e kane pranuar kete Statut te Gjykates.

#### Neni 70

Gjykata mund te propozoje, me shkresë drejtuar Sekretarit te Pergjitheshem per t'i shqyrtuar simbas dispozitave te nenit 69, amendmentet ne kete Statut qe do t'i gjykoje te nevojeshme.